

Porosia e pejgamberit ﷺ - Provat e pejgamberllëkut

Muhamed el-Shinawi, yaqeeninstitute.org

Porosia e sjellë nga pejgamberi Muhamed ﷺ, pra Kurani që ai recitonte dhe Suneti i tij, dëshmon për vërtetësinë e vet. Edhe para se të marrësh një gjykim për madhësitë morale apo intelektuale të kësaj porosie, thjesht vetëm vëllimi i asaj çfarë është dokumentuar nga aktiviteti njëzetetrevjeçar i Muhamedit ﷺ është e admirueshme. Kjo porosi nuk mund të krahasohet me Biblën, fjala vjen, meqë Bibla nuk përmban mësimet e Musës (Moisiut), por është një ligj historik i përmbledhur, zhvillimi i të cilit shtrihet nëpër shekuj.

Pastaj ki parasysht vlerën e asaj çfarë ai ﷺ predikoi si në kuptimin e kualitetit qenësor, si në shtrirjen e saj. Kjo porosi përkufizoi marrëdhëniet e njerëzve me Krijuesin e tyre, me ata që i kanë përreth, madje dhe me kafshët dhe me objektet e pajetë, duke ofruar urtësi të përhershme lidhur me çdo gjë që ka të bëjë me mirëqenien e tyre individuale a kolektive.

Po ashtu ki parasysht harmoninë e një korpusi gjithëpërfshirës që ka të bëjë me teologjinë, me sjelljen individuale, me sjelljen shoqërore, me ligjet civile, me politikën e jashtme, me adhurimin ritual e me perceptimin shpirtëror, gjë që pa dyshim se është mahnitëse, në mos krejtësisht një mrekulli. Kjo bëhet më e qartë më tej, kur bie në kontrast me doktrinat e tjera fetare e ligjore, të cilat veniten përballë kritikës dhe kalimit të kohës.

Paaftësia e vazhdueshme e qenieve njerëzore për të shpikur një sistem të përhershëm, që do të vendoste baraspeshën dhe mirëqenien e përgjithshme, na bën ta çmujmë edhe më shumë porosinë e pejgamberit të fundit ﷺ.

Ky punim paraqet dhjetë pika nga porosia e tij ﷺ, duke u përqendruar në ato që më së shumti vlerësohen nga njerëzit e shekullit 21.

Monoteizmi absolut

“Thuaj (O Muhamed): ‘Kjo është rruga ime. Thërras për tek Allahu me dije të sigurt, unë dhe ata që më ndjekin.’” (Jusuf, 108)

Pejgamberi Muhamed ﷺ asnjëherë nuk u kërkoi njerëzve ta adhuronin atë. Ai, madje, nuk lejonte që ndokush të shprehte respektim të tepruar ndaj tij. Ai gjithmonë bënte një dallim të theksuar mes hyjnore dhe natyrës së vet njerëzore. Ai ﷺ ndalonte njerëzit t'i ngriheshin në këmbë, kur hynte, dhe u bënte vërejtje njerëzve, kur ata aludonin në barabarësinë mes tij dhe Allahut në të folurën e tyre. Ndërsa ishte në pragun e vdekjes ai paralajmëroi kundër veprimeve të popujve të kaluar, të cilët i kthyen në tempuj adhurimi (mauzole) varret e pejgamberëve të tyre. Asgjë në porosinë e tij nuk dallohej më shumë

sesa entuziazmi për ta mbrojtur të kuptuarit e shëndoshë të monoteizmit në zemrat e njerëzve dhe për të hequr çfarëdo pengese mes individëve dhe lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë dhe personale me Zotin.

Leo Tolstoj (vdiq 1910) vinte nga një familje aristokrate ruse dhe përshkruhet nga disa si novelisti më të mirë i të gjitha kohëve. Shumë kanë përcjellë admirimin që ai kishte për Islamin. Ndër thëniet që atribuohen atij lidhur me këtë është edhe kjo:

“Muhamedi gjithmonë ka qëndruar më lart se krishterimi. Ai nuk konsideron Zotin të jetë një njeri dhe asnjëherë nuk barazon veten e vet me Zotin. Muslimanët nuk adhurojnë gjë tjetër veç Zotit dhe Muhamedi është i Dërguar i Tij. Në këtë s’ka kurrfarë misteri apo ndonjë sekret.”

Në një vend tjetër, ai shkruan: “Pasi lexova Kuranin, kuptova se i gjithë njerëzimi ka nevojë për këtë ligj hyjnor.”¹

Nevoja më e madhe ekzistenciale e njerëzimit është që ta identifikojë Zotin e vërtetë. Vetëm besimi në Të përputh arsyen me intuitën. Njerëzit janë krijesa me qëllim, kështu që vetëm një që ka urtësi dhe qëllim ka mundur t’i pajisë ata me qëllim. Krijuesi, po ashtu, do të duhej të na e kumtonte atë qëllim, prandaj dhe thirrja a pavdekshme e modelit “shpallje hyjnore” të fesë, pra ai i “të Dërguarve të frymëzuar nga hyjnorja.”

Për sa u përket feve të tjera, ato përfshijnë filozofi të kufizuara, që nuk arrijnë t’u japin përgjigje pyetjeve më të mëdha e më urgjente lidhur me qëllimin dhe atë çfarë i jep kuptim jetës. Pasi kërkimi i personit të ngushtohet vetëm në besimet Abrahamike, veçantia unike e Islamit rreth njësisë së Zotit bëhet krejtësisht e qartë. Vetëm në Islam njeriu gjen një Zot që është absolut në njësinë dhe përsosurinë e Tij, të lartësuar mbi shëmbëllimin me krijesat dhe njësoj përdëllimtar ndaj tërë njerëzimit, duke iu drejtuar të gjithëve me porosinë e njëjtë.

Paracaktimi

Allahu ﷻ thotë:

“Asnjë fatkeqësi nuk ndodh në tokë apo në vetët tuaja pa qenë e shënuar në Regjistrin para se Ne ta realizojmë. Vërtet kjo është e lehtë për Allahun. Kjo me qëllim që të mos dëshpëroheni për atë që ju ikën dhe të mos ngazëllehëni për atë që Ai ju jep. Dhe Allahu nuk e do asnjë mburracak që lëvdohet.” (el-Hadid, 23)

¹ *Treatise on Sayings of Muhammad*, by Count Lev Nikolayevich Tolstoy

Herbert Benson, MD, një bashkëthemelues i Institutit Benson-Henry për Mjekësi Mendore e Trupore thotë: “Besimi në Zot është mjeti më i mirë parandalues për stresin dhe sistemin e shëndoshë të imunitetit. Besimi se një dorë kontrollon gjithçka qetëson mendjen.”² Siguria për të cilën ai flet – kur personi beson se vetëm një dorë kontrollon gjithçka – është saktësisht mënyra sesi pejgamberi Muhamed përkufizoi fatin: “... të besosh në paracaktimin, të mirën e të keqen e tij (Dmth krejt ndodh me lejen e Allahut).”³ Pa këtë besim, personi do të mbetet në ankthin e një mundësie dualizmi (forca kozmike konkurruese). Kjo, sipas radhës, do ta shkatërronte integritetin shpirtëror të personit, sepse, edhe nëse ata do ta adhuronin Zotin, prapëseprapë do të shqetësohej nga forcat e tjera konkurruese në univers. Pra, me bindjen se gjithçka ndodh vetëm me vullnetin dhe caktimin e Tij dhe se Ai bën që gjërat të ndodhin në ekzistencë, rehatia e brendshme bëhet e arritshme.

Ngjashëm, Edward T. Creagan, MD, nga Mayo Clinic, një anëtar bordi në Shoqatën Amerikane të Kancerit, përshkruan mjetin më të efektshëm kundër stresit si: “Pranimi se jeta nuk është e drejtë gjithmonë dhe njeriu i mirë nuk fiton çdo herë.”⁴ Me fjalë të tjera, besimi se çdo gjë është dhe do të jetë përherë në dorën e Zotit dhe Zoti bëri që jeta të ketë ngritjet dhe rëniet për një urtësi që vetëm Ai e di krejtësisht, janë dy burime të fuqishme që e bëjnë jetën të durueshme dhe të admirueshme. Këto besime qenë mësuar vazhdimisht nga pejgamberi Muhamed ﷺ dhe ndjekësit e tij vazhdojnë të gjejnë rehati në të, kur përballen me varfëri, frikë dhe sfida të tjera.

Namazi

Lutja rituale është shtylla e dytë e Islamit pas dëshmisë së besimit (*shahadetit*). Gjuhësisht kjo lutje do të thotë lidhje. Kjo është një shans për njerëzit të tërhiqen nga makineria rrotulluese e kësaj jete për të përforcuar marrëdhënien e tyre me Krijuesin, për ta ujitur pemën e besimit të tyre dhe për t'i freskuar shpirtrat të cilët përndryshe do të thaheshin dhe çaheshin në shkretëtirën e një kërkimi të pafund të bollëkut dhe kënaqësive trupore. Për shpirtin namazi është sikurse ikja në një hije të pemës në vllugun e punës në një ditë me vapë. Kjo është një shans për ta ripërtërirë gjendjen tonë shpirtërore, për ta kujtuar origjinën tonë, Krijuesin tonë, dhe qëllimin e

² *Treatise on Sayings of Muhammad*, by Count Lev Nikolayevich Tolstoy

³ Muslim

⁴ <http://www.mayoclinic.org/healthy-lifestyle/stress-management/expert-blog/life-is-unfair/bgp-20056039>

ekzistencës sonë. Nëse kjo bëhet me devocion, mund të jetë zbrapsja më e efektshme nga keqbërja dhe padrejtësia.⁵

Pejgamberi Muhamed ﷺ u kërkoi muslimanëve të falnin namaz pesë herë në ditë për çdo ditë. Ndonëse disa njerëzve kjo mund t'u duket punë e mundimshme, shumë muslimanë – pasi ta kryejnë namazin – zgjedhin me vullnetin e tyre t'u shtojnë edhe më shumë këtyre pesë namazeve. Forca magnetike e këtij akti devotshmërie duhet të jetë një shenjë e qartë e domethënies së tij. Namazi është fryti (dhe fara) më i dukshëm i bindjes, siç citohet edhe Jezu Krishti të ketë thënë: “Ju do t'i njihni nga frytet e tyre. A vilet rrush nga ferrat ose fiq nga murrizat?” (Mateu 7:16)

Papa Xhon Pali II i vonë, pavarësisht dallimit të tij ideologjik me Islamin, në një rast u shpreh:

“Fetaria e muslimanëve meriton respekt. Është e pamundshme të mos admirosh, fjala vjen, besnikërinë e tyre ndaj namazit. Imazhi i besimtarëve në Allahun të cilët, pa çarë kokën për kohën dhe vendin ku gjenden, bien në gjunjë dhe zhyten në lutje, mbetet një shembull për të gjithë ata që lusin Zotin e vërtetë, sidomos të krishterët të cilët, duke qenë se kanë braktisur katedralet e tyre madhështore, luten vetëm pak apo aspak.”⁶

Pa dyshim, dobia më e madhe e namazit është lidhja me Zotin. Kjo lidhje kultivon një elasticitet shpirtëror, i cili ndihmon njeriun të realizojë qëllimin e tij në këtë jetë dhe të kualifikohet për shpëtim në jetën e përtejme. Krahas kësaj, edhe dobitë mendore dhe fizike të namazit ditor të muslimanëve janë të mahnitshme. Në rrafshin mendor / psikologjik, studimi sugjeron se namazi shton vetëkontrollin ndërsa zbraps efektet negative shëndetësore të përjetimeve ditore. Duke pasur parasysh shtimin e madh të shqetësimit, depresionit, abuzimit me drogën, dhe vetëvrasjeve përreth nesh, bota që lëngon dëshmon për rëndësinë e rivënies së lidhjes së namazit ditor të muslimanit: “Ata thirreshin të bënin namaz sa ishin të shëndoshë.” (el-Kalem, 43)

Agjërimi

Agjërimi është një tjetër shtyllë e Islamit që, së paku gjatë muajit ramazan, praktikohet nga mbi një miliardë muslimanë në tërë botën. Prej agut deri në perëndim të diellit, muslimani, nga devocioni që ka ndaj Krijuesit, përmbahet nga ngrënia e ushqimit, nga pirja, dhe nga marrëdhëniet seksuale. Ky kufizim i apetiteve trupore ushqen spiritualitetin, rivendos vetëdijen fetare, dhe

⁵ Hatem al-Hāj, MD, *Fiqh of Worship: A Commentary on Ibn Qudāmah's "Umdat al-Fiqh"*, IIPH (2011)

⁶ *Crossing the Threshold of Hope: John Paul II on Islam*, 1994

kultivon sinqeritet në kryerjen e detyrave ndaj Zotit, meqë vetëm Zoti mund të mbikëqyrë gjatë gjithë kohës. Agjërimi po ashtu mëson vetëpërbajtje në sferat e tjera të jetës, siç mësojmë nga thënia e peygamberit Muhamed ﷺ:

“Kush nuk heq dorë nga të folurit e ndytë gjatë agjërimin, (le ta dijë se) Allahu nuk ka nevojë për përbajtjen e tij nga ngrënia e ushqimit dhe pirja.”⁷

Natyrisht, agjërimi gjithashtu i mundëson muslimanit përjetimin e urisë dhe bezdisë, duke prodhuar kështu dhembshuri ndaj të paprivilegjuarve dhe të shtypurve. Për këtë arsye, peygamberi Muhamed ﷺ tregojë edhe më bujar në ramazan⁸ dhe obligoi ndjekësit e tij me një sadaka të obligueshme (sadikanë e fitrit) në fund të këtij muaji.

Për sa u përket dobive shëndetësore nga agjërimi, këto janë edhe fizike, edhe psikologjike. Në një studim të bërë nga Mattison dhe Lane (2003) pranë National Institute of Aging në Baltimor, u gjet se kufizimi i kalorive shton jetëgjatësinë dhe pakëson paraqitjen e sëmundjeve të pleqërisë. Ngjashëm me këtë, Clive McCay PhD pranë Cornell University, gjeti se minjtë laboratorik, të mbajtur me një dietë me shumë pak kalori, jetonin pothuajse dy herë më gjatë sesa pritej, për sa kohë që u jepej ushqimi i duhur. Dhe në eksperimentin e njohur “Canto and Owen”, hulumtuesi në fushën kundër plakjes Richard Weindruch PhD, pranë University of Wisconsin’s School of Medicine and Public Health, publikoi një dokument që tregon për dy majmunë Rhesus të moshave të ngjashme me dieta të ndryshme. Hulumtimi i tij nxori në pah faktin se “kufizimi i kalorive” dhe “agjërimi” kthejnë mbrapsht dhe ngadalësojnë shkatërrimin qelizor që vjen me plakjen. Për sa u përket efekteve terapeutike të agjërimin në shëndetin mendor, Dr. Juri Nikolajev i Fasting Clinic of The Moscow Institute of Psychiatry, ka monitoruar efektin pozitiv të agjërimin për mijëra pacientë me skizofreni të cilët nuk ndikonin barërat.

Të ushqyerit e shëndetshëm

Allahu ﷻ thotë:

“O fëmijët e Ademit, zbukurohuni në namazet tuaja, hani e pini, por mos e teproni. Vërtet Ai nuk i do ata që e teprojnë.” (el-A’rafë, 31)

Këto instruksione hyjnore nuk mbeten të pashpjeguara. Detajet e holla u ofruan nga peygamberi Muhamed ﷺ lidhur me ushqimin, pijen, dhe veshjen.

⁷ El-Buhari (6057)

⁸ Ibn Abbas tha: “Peygamberi qe njeriu më bujar nga të gjithë dhe ai bëhej edhe më bujar në ramazan, kur takohej me Xhibrilin, i cili vinte tek ai çdo natë të ramazanit për ta përsëritur Kuranin me të. I Dërguari i Allahut ishte më bujar sesa era e shpejtë.” (el-Buhari, 3554)

Për shembull, muslimanëve u ndalohet të hanë mishin e derrit⁹, përveç në rastet kur detyrohen, ndërsa nuk u sugjerohet (jo ndalohen) nga ngrënia e mishit të lopës, me qëllim që t'u shmangen ndërlikimeve shëndetësore. Në një hadith thuhet:

“Ju këshilloj të pini qumështin e lopës, se ato hanë nga të gjitha bimët dhe (qumështi i saj) përmban ilaç për çdo sëmundje.”¹⁰

Në një tjetër transmetim, thuhet:

“Shmanguni nga mishi i lopës, se ai është (shkak për) sëmundje.”¹¹

Jo vetëm që është trajtuar lloji i ushqimit, por edhe sasia. Pejgamberi ﷺ tha:

“Njeriu nuk mbush enë më të keqe sesa barkun e vet. I mjaftojnë birit të Ademit disa kafshata sa për ta mbajtur shpinën drejt. Megjithatë, nëse atij i duhet të hajë (më shumë), atëherë le të jetë një e treta ushqim, një e treta pije, dhe një e treta ajër.”¹²

Për ta çuar më tej këtë metodë të shkëlqyeshme, muslimanëve u është dhënë nga pejgamberi i tyre një plan për arritur deri te ngrënia e pakët, duke i kaluar ata nga ana abstrakte e udhëzimit në atë praktike. Enesi ؓ përcjell se pejgamberi ﷺ i ndaloi ata nga pirja në këmbë¹³ dhe (Enesi shtoi):

“... dhe ngrënia në këmbë është edhe më e keqe.”

Ky këshillim rreth ngrënies dhe pirjes me kujdes është çelësi¹⁴ i provuar për shmangien nga rreziqet e ngrënies së tepërt dhe trashësisë (obezitetit).

Ndalimi nga tradhtia bashkëshortore

Sthurja seksuale, pa dyshim, ka qenë një udhë e errët për botën sekulare. Megjithatë, pavarësisht politizimit të seksualitetit, do të gjesh ekspertë gjithandej spektrit ideologjik që ende pranojnë rolin e ndershmërisë, përmbajtjes seksuale para martesës, dhe besnikërisë bashkëshortore në parandalimin e sëmundjeve të transmetuara seksualisht. Këto vlera mbrojtëse

⁹ Ky është edhe një ndalim biblik: “edhe derri, që e ka thundrën të ndarë por nuk përtypet, është i papastër për ju. Nuk do të hani mishin e tyre dhe nuk do të prekni trupat e tyre të vdekur.” (Deutoronomi, 8)

¹⁰ *Sahih el-Xhami* (4061)

¹¹ Et-Tirmidhi (2380) dhe Ibn Maxheh (2/1111)

¹² Muslim (2024)

¹³ *Putting an End to Mindless Munching*, The Wall Street Journal, by Melinda Beck – Durham, N.C.

¹⁴ Ahmed (21705)

që na u mësuan nga pejgamberi ﷺ, shoqërohen me raste të pakta të infeksioneve HIV në shumicën e popujve muslimanë. Allahu ﷻ thotë:

“Mos iu afroni marrëdhënieve të paligjshme seksuale. Vërtet që kjo është paturpësi e madhe dhe rrugë e keqe.” (el-Isra, 32)

Jo vetëm që pejgamberi Muhamed ﷺ solli këtë ajet, i cili ndalon nga marrëdhëniet seksuale jashtë martesës, por përvijoi për ne një kod sjelljeje për t'i parandaluar edhe mënyrat që çojnë në këtë. Civilizimet që nuk respektojnë këtë kod, gjithmonë kanë përfunduar në një pikë pa kthim. Seksualiteti i pafre shuan arsyen dhe, siç kumton ajeti, marrëdhëniet e shfrenuara seksuale janë një udhë e keqe, jo një përfundim i keq. Kjo fillon me marrëdhënie seksuale jashtë martesës, pastaj me identifikimin sipas orientimit seksual, të pasuar nga pranimi i të gjitha formave të shprehjes seksuale, madje dhe të bestialitetit dhe nekrofilisë. Nga këndvështrimi i saktë shpërfaqet një njohje e re: “Mos iu afroni marrëdhënieve të paligjshme seksuale ...”, sikur kjo të ishte një flakë e egër që përfshin ata që vetëm i afrohen asaj.

Një tjetër mënyrë me të cilin Islami pengon këtë kërcënim është theksimi i sistemit familjar. Marrëdhënia e paligjshme seksuale nuk është vetëm ftesë për sëmundjet trupore, por kjo përfaqëson një mendësi vetjake, që shpërfill familjet të cilat shkatërron, fëmijët e privuar nga dashuria dhe kujdesi, abortet e vona milionëshe, sistemet e burgut që të gjithë ne paguajmë, dhe gjëra të ngjashme. Islami instalon kujdesin ndaj krejt kësaj dhe po ashtu nderin dhe përgjegjësinë shoqërore. Marrëdhënia e paligjshme seksuale, madje, bën që të moshuarit të vdesin vetëm dhe të refuzuar, meqë, ata që kanë prindër të pamartuar (apo të panjohur për fëmijën), sigurisht se do të ndahen edhe më tej nga gjyshërit. Për pasojë, të vjetrit gjejnë veten të braktisur në një moshë të thyer, që zakonisht kërkon praninë e familjes së gjerë për të bartur barrën së bashku. Pejgamberi ﷺ vuri në dukje këto rreziqe në shumë raste, si p.sh. kur këshilloi të riun që po sfidohej nga epshi i tij: “A do ta pranoje (marrëdhënien e paligjshme seksuale) për nënën tënde, për motrën tënde, për bijën tënde ...?”¹⁵ Krahas kësaj, ai ﷺ rivendosi lidhjen e familjeve të zgjeruara duke thënë: “Tezja është si nëna.”¹⁶

Ndalimi i kamatës

Xhabir bin Abdullah ﷺ tregoi:

¹⁵ Et-Tirmidhi (1904) dhe Ebu Daud (2278)

¹⁶ Muslim (1598)

“I Dërguari i Allahut mallkoi konsumuesin kamatës, paguesin e saj, dokumentuesin e saj, dy dëshmitarët e saj, dhe tha: ‘Të gjithë këta janë të barabartë (në këtë gjynah).’”¹⁷

Në kaluarën dhe tani, njerëzit kanë shpërfillur rrezikun e transaksioneve të bazuara në kamatë, sidomos kur kjo është bërë me pëlqimin e ndërsjellë. Mirëpo, urtësia hyjnore tejkalon kritikën tonë shkurtpamëse dhe e vlerëson këtë model financiar si diçka serioze. Allahu ﷻ thotë:

“O ju që keni besuar, kini frikë Allahun dhe hiqni dorë nga kamata e mbetur (që dikush ju ka borxh), nëse vërtet jeni besimtarë. Nëse nuk e bëni këtë, merrni njoftim për një luftë (kundër jush) nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, ju mund ta mbani kapitalin themelor (pa sasinë e kamatës). Mos u bëni të padrejtë (duke kërkuar më shumë nga sa keni dhënë) dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi (duke ju dhënë më pak nga sa keni dhënë).” (el-Bekare, 278-279)

Sot, ne shohim nga afër sesi institucionet e bankimit të bazuara në kamatë kanë shkatërruar shtete përtej mundësisë së përmirësimit dhe po ashtu individë. Natyra e egër e kamatës është e qartë: ajo duket të jetë një mënyrë e shpejtë pasurimi, por, në fakt, i zhyt njerëzit më tej në borxhe. Ajo vendos tërë rrezikun në huamarrësin, ndërsa nuk kanos aspak huadhënësin që “investon” në huadhënie. Kjo gjithashtu përçmon punën, meqë këtu paraja nxjerr paranë, jo munda apo mjeshtëria. Për rrjedhojë, të pasurit vijnë duke u bërë më të pasur, kurse të varfrit vijnë duke u bërë më të varfër deri në pikën e një shkatërrimi të paimagjinueshëm, i cili, sipas radhës, përshpejton rrënimin financiar dhe rebelimin që ka përpirë shumë popuj, madje dhe superfuqi. Duke vënë në pah këtë lloj pabarazie, Zoti thotë lidhur me paratë:

“Në mënyrë që paraja të mos shpërndahet vetëm mes të pasurve mes jush.” (el-Hashr, 7)

Nga ky shkak, peygamberi Muhamed ﷺ shpalli si të paligjshëm përfitimin nga kreditë me kamatë duke thënë:

“Përfitimi varet nga përgjegjësia / detyrimi (mundësia e humbjes).”

Kur t’i shtosh kësaj rreziqet e kamatës dhe spekulimet e tepërta (*gharar*), të cilat peygamberi ﷺ i ndaloi po ashtu, do t’i kesh të gjitha përbërësit e një krize ekonomike; dhe krizën financiare të vitit 2008 ende e mbajmë mend. Për këtë arsye, një trend global po shfaqet në Evropë¹⁸ dhe tjetërkah, që pranon se

¹⁷ Et-Tirmidhi (1303)

¹⁸ “Vatican Paper Supports Islamic Finance. France Wants its Share of Sharia Banking”, *The Brussels Journal*, 3/12/2009 – Original paper:

rregullimin financiar i Islamit ofron një alternativë këndëllëse dhe një ilaç për belatë ekonomike.

Kodi penal

Ka vetëm pesë ndëshkime të autorizuara, të cilat u urdhëruan veçanërisht nga pejgamberi Muhamed ﷺ. Ndryshe nga miti aktual, një libër tipik i ligjit tradicional islamik, që shpesh shtrohet në disa vëllime dhe në thelb është një përmbledhje direktivash pejgamberike të shqyrtuara sipas situatave të caktuara, kaptina e kodit penal (*hudûd*) përbën rreth 2% të librit. Për më shumë, shqyrtimi i këtij 2 %-shi shpalos arsyen përse këto pesë ndëshkime zbatohen rrallëherë në shoqëritë islame të cilat praktikojnë Sheriatin (ligjin islamik) dhe përse këto funksionojnë si duhet vetëm përbrenda një sistemi tërësor, që inkurajon vlerat që këto ndëshkime synojnë t'i mbrojnë.

Megjithatë, edhe këto pesë ndëshkime kanë një madhësi të tyre ligjore. Përse pejgamberi ﷺ urdhëroi ndëshkimet për vjedhje dhe marrëdhënie seksuale jashtë martesës e jo edhe për ngrënien e mishit të derrit, për bixhoz e për kamatë? Kjo duket të nënkuptojë se kodi penal nuk është vetëm që Zoti të hakmerret ndaj atyre që shkelin kufijtë e Tij. Vërtet, kjo ka të bëjë më shumë me mbrojtjen e individit dhe të shoqërisë nga veset e tyre. Vjedhja dhe marrëdhënia seksuale jashtë martesës ofrojnë një fitim apo kënaqësi të menjëhershme, një forcë e madhe shtytëse të cilës disa nuk mund t'i rezistojnë pa frikën e ndëshkimit mjaftueshëm serioz për ta penguar atë lakmi apo epsh. Në anën tjetër, ndonëse transaksionet e bazuara në kamatë janë më të dënueshme në Islam sesa vjedhja apo marrëdhëniet seksuale jashtë martesës, për to nuk ka ndëshkime të përcaktuara. Kjo s'është një mosparimësi, por një nuancë e mençur: një pranim i faktit se kamata është një krim që shemb ngadalë shoqërinë si tërësi, ndryshe nga vjedhja që bëjnë njerëzit të cilët s'mund të përmbahen, për shkak se ofron pasurim të menjëhershëm.

Në një artikull të publikuar në Policy Studies Journal, u propozua një revizion i teorisë së parandalimit nëpërmjet frikësimit apo dekurajimit. Në thelb, ajo teorizon se krimi mund të parandalohet më mirë nëpërmjet ndryshimit të raporteve kosto-përfitim të kalkuluara nga kriminelët. Autori thotë:

“Gjejmë në literaturë dhe në analizat tona empirike se, pasi që ndëshkimit të merret parasysh në një model, ashpërsia e ndëshkimit ka një ndikim negativ

në krimin dhe vërtet vlen si një teori parandalimi nëpërmjet frikësimit siç na tregon teoria.”¹⁹

Me fjalë të tjera, një kriminel zakonisht merr parasysh gjasat për t’u kapur si edhe ashpërsinë e ndëshkimit, nëse kapet. Kështu, baraspeshimi i këtyre dy faktorëve do ta minimizojë krimin në mënyrën më të efektshme.

Ndonëse efektshmëria e teorive të ndryshme të parandalimit nëpërmjet frikësimit ende debatohet në forumet e kriminologjisë, shumë gjëra mbështesin qëndrimin se bota sekulare – në një orvatje të lavdërueshme për t’iu shmangur ligjeve të ashpra – e ka tepruar në theksimin e frikësimit apo dekurajimit të kriminelëve me anë të mbikëqyrjes së përmirësuar, policisë më agresive, dhe sofistikut të instrumenteve për hetimin e krimit (forenzikës). Kjo ka ndodhur në dëm të rishqyrtimit të ndëshkimit aktual pas kapjes së kriminelit. Për shkak të kësaj dashamirësie të pavend në emër të qytetarisë, shumë jetë janë humbur dhe shumë të tjera janë shkatërruar. Kini parasysh Shtetet e Bashkuara, për shembull, sistemi i dështuar i burgimit i të cilave zë vendin e parë në planet për nga numri i burgosjeve (mbi dy milionë të burgosur), për krimet me armë, dhe për përdorimin e kanabisit. Për më shumë, siç thekson profesori amerikan i ligjit Peter Moskos në librin e tij *In Defence of Flogging*, nocioni se burgosja e dikujt në një qeli është më njerëzore sesa t’i shkaktosh atij një dhimbje trupore të shkurtër e të madhe, është një trill kulturor kolektiv. Është interesante sesi, me të kolonizuar Indinë muslimane, zyrtarët britanikë, në pjesën e hershme të shekullit 18-të, ndien se ligji islamik përshtatej mirë me “drejtësinë e përgjakshme” të Anglisë dhe Evropës.²⁰ Pastaj ata ndërhyjnë duke argumentuar se “ligji islamik ishte tepër i butë në shumë aspekte. Qëllimi i legjislacionit britanik qe ta kufizonte këtë butësi.”²¹ Butësia e këtyre ligjeve vërehej në disa aspekte: së pari, mungonin burgosjet e përjetshme dhe metodat e ashpra të ekzekutimit; së dyti, siç vërejtë një zyrtar britanik i vitit 1700, ndëshkimi për vjedhje, në të vërtetë, zbatohet shumë rrallë.”²²

Përmbledhtas: Pejgamberi Muhamed ﷺ, për t’i frikësuar shkelësit potencialë deri në heqje dorë nga krimi joshës, autorizoi vetëm pesë ndëshkime specifike, edhe pse këto janë zbatuar shumë rrallë. Edhe atëherë kur janë zbatuar, kanë qenë shumë më të buta sesa ndëshkimet moderne të krimit.

¹⁹ Mendes, Silvia M., and Michael D. McDonald. 2001. Putting Severity of Punishment Back in the Deterrence Package, *Policy Studies Journal* 29 (4): 588-610.

²⁰ Jörg Fisch, *Cheap Lives and Dear Limbs: The British Transformation of the Bengal Criminal Law 1769-1817* (Wiesbaden: Franz Steiner, 1983), p.88

²¹ Ibid (f. 7)

²² Ibid (f. 88)

Higjiena personale

Fjalët në vijim i atribuohen pejgamberit Muhamed ﷺ:

“Dhjetë veprime janë nga *fitra* (animi natyror): shkurtimi i mustaqeve, lëshimi i mjekrës, pastrimi i dhëmbëve, shpëlarja e hundës, shkurtimi i thonjve, larja e nyejve të gishtërinjve, ndukja (rruajtja) e nënsqetullave, rruajtja e qimeve në pjesën intime, dhe pastrimi me ujë pas kryerjes së nevojës fiziologjike.”

Një transmetues tha: “Kam harruar të dhjetën. Mund të jetë shpëlarja e gojës.”²³

Kur personi të reflektojë mbi urtësinë e këtyre mësimëve, të shohë ndikimin e zbatimit të tyre dhe t'i shqyrtojë ligjet e Islamit nga këndvështrimi i objektivave më të larta të tyre, nuk mund të mos përjetojë një trazim intelektual dhe shpirtëror. Këto dhjetë veprime më lart, për shembull, jo vetëm që provojnë të qenët e pejgamberit ﷺ të fundit shekuj më përpara sesa shumica e civilizimeve progresive të kohës së tij, por po ashtu tregojnë natyrën përdëlltare të hyjnore, domethënë sa i mirë dhe përdëllimtar ndaj krijesave është Zoti i plotfuqishëm.

George Bernard Shaw (vdiq. 1950), një kritik e dramaturg irlandez me ndikim, shkruan:

“Formuluesit e fesë autoktone, siç është Muhamedi, qenë mjaftueshëm të përparuar që të prezantonin si detyra fetare masa të tilla sanitare siç është abdesi dhe trajtimin më të kujdesshëm e respektues të çdo gjëje që lëshon trupi njerëzor, madje dhe prerjen e thonjve e të qimeve. Misionarët tanë, pa menduar, hodhën poshtë këtë doktrinë devocioni duke mos e zëvendësuar si duhet, çka bëri që vendin e saj ta zënë përtacia dhe shkujdesja.”²⁴

Larja nuk ka qenë traditë e Evropianëve deri në shekullin e 11-të. Mortajat vizitonin rregullisht banimet e tyre johigjienike dhe ata bartnin tesha të lyera me baltë, derisa u binte nga trupi. Asokohe, muslimanët pastroheshin për lutjet e tyre, lanin trupin pas marrëdhënieve seksuale, madje lanin edhe të vdekurin për më shumë se 400 vjet! “Në vitin 1000 (p.e.s.), Kryqtarët u kthyen nga Lindja me lajmin e një zakoni që kënaq – banjën turke. Banjat publike janë ndërtuar gjithandej Evropës.”²⁵

²³ Muslim (1/223), Ebu Daud (1/14), Ibn Maxheh (1/107), et-Tirmidhi (5/91), dhe en-NEsa'i (5/405).

²⁴ *The Doctor's Dilemma: Preface on Doctors*, by George Bernard Shaw, 1908

²⁵ The Dirty Secrets of Bath Time, Times Online, March 26, 2009

Islam, madje, dekurajon nga konsumimi i qepëve të papërgatitura, nxit për shpëlarjen e rregullt të gojës dhe pastrimin e shpeshtë të dhëmbëve që nga dalja e tyre. Pejgamberi ﷺ tha:

“Brusha e dhëmbëve është pastrim për gojën dhe mënyrë afrimi tek Zoti.”²⁶

Pejgamberi i fundit i Islamit, Muhamedi ﷺ, mësoi se këto janë mënyra të afrimit tek Zoti dhe rehati për njerëzit e për engjëjt, të cilët po ashtu bezdisen nga erërat e pakëndshme. Me përparimin e sotëm teknologjik, kuptojmë sa i efektshëm është largimi i sheqerit nga goja në parandalimin e prishjes së dhëmbëve dhe agoninë që del nga infeksioni i mishit të dhëmbëve.

Pejgamberi Muhamed ﷺ instrukttoi muslimanët ta shpëllajnë hundën si pjesë e pastrimit para namazit të tyre. Studiuesit sot kanë nisur të zbulojnë sa e vlefshme mund të jetë kjo praktikë; një studim “nxori përfundimin se pastrimi me ujë i zgavrave të hundës ka një potencial të madh në përmirësimin e kualitetit të jetës së miliona pacientëve në një mënyrë që të kursen mjaft para.”²⁷ Rinologët kësaj i referohen si “ujtje nazale”, duke qenë se përshkimi i një sasive të vogël uji nëpër kanalën e hundës, ndër të tjera, është mënyra e duhur për ta trajtuar dhe parandaluar sinusitin. Kjo është pikërisht çfarë përshkroi pejgamberi ﷺ në thënien e tij:

“Thitheni bollshëm ujin me hundë (gjatë abdesit), përveç kur jeni agjërueshëm.”²⁸

Me fjalë të tjera, uji duhet pothuajse ta mbërrijë fytin gjatë shpëllarjes së hundës, prandaj duhet pasur kujdes gjatë agjërit.

Edhe në botën e sotme moderne, ku higjiena superiore është thelbësore për popullatën e saj përgjithësisht të shëndoshë, njerëzit ende nuk janë aq të motivuar në aspektin higjienik sa kanë qenë muslimanët për gati 1500 vjet. Kjo në vijim është nga vebajti i mirënjohur i Mayo Clinic:

“Pavarësisht dobive të provuara të larjes së duarve, shumë njerëz nuk e kanë bërë shprehi këtë aq sa duhet, madje dhe pas përdorimit të tualetit. Gjatë ditës, ti akumulon në duart e tua baktere nga burime të ndryshme, siç është kontakti i drejtpërdrejtë me njerëzit ... Nëse ti nuk lan duart sa duhet shpesh, mund ta infektosh veten me këto baktere duke prekur sytë, hundën, dhe gojën. Dhe ti po ashtu mund të përhapësh këto baktere tek të tjerët ... “

²⁶ Ahmed (6/47) dhe en-Nesa'i (1/50)

²⁷ Tomooka L. et al. (2000) Clinical Study and Literature Review of Nasal Irrigation. *The Laryngoscope*

²⁸ Ebu Daud (142, 143), et-Tirmidhi (38), en-Nesa'i (1/66, 69), dhe Ibn Maxheh (448).

Shkenca dhe mjekësia

Kjo mund të jetë pjesa më e papërfillur e mësimeve të peygamberit Muhamed ﷺ, edhe pse për këtë i jemi gati më së shumti borxh - fakti se ia mësoi botës rëndësinë e dijes! Duke i liruar nga birucat e injorancës dhe besëtytnive, ai mësoi ndjekësit e vet për domosdoshmërinë e investimit të jetëve të tyre në edukim; për rrjedhim, ata u bënë paraprijës në çdo fushë. Ai ﷺ vlerësoi potencialin intelektual të ithtarëve të tij duke thënë:

“Ju njihni më mirë punët e kësaj bote.”²⁹

Deklaratat si kjo mësuan muslimanët e hershëm se duhet respektuar e inkurajuar përvojat jetësore dhe ekspertizat që nuk trumbetohen nga dogma të pabaza.

Nisur nga ky botëkuptim, Islami ishte i pari që detyroi përgjegjësinë e një mjeku dhe ithtarët e tij vendosën standarde intelektuale për shekuj. Kjo s’ishte një rastësi, por një nën-produkt i thënies së peygamberit të tyre:

“Ai që praktikon mjekësinë duke mos qenë kompetent, do të merret në përgjegjësi.”³⁰

Duke pasur parasysh këtë thënie, Bagdadi i shekullit të dhjetë vendosi testin e mjekësisë, nëpër të cilin duhej të kalonin të gjithë mjekët para se të merreshin me mjekësi.³¹

Në një transmetim tjetër:

“Allahu nuk zbriti ndonjë sëmundje e të mos ketë zbritur edhe ilaçin për të, pavarësisht a e di apo nuk di ndokush.”³²

Thënë ndryshe, peygamberi ﷺ u thoshte njerëzve se këto ilaçe mund të zbulohen, kështu që le të fillojë hulumtimi! Muslimanët kanë qenë aq të përparuar në mjekësi, saqë William Osler, një themelues dhe kryetari i dytë i

²⁹ Muslim (2363) dhe Ahmed (24964).

³⁰ Ebu Daud (4576), Ibn Maxhe (3466), dhe en-Nesa’i (4845)

³¹ Firas AlKhateeb, *Lost Islamic History* (p. 72), Oxford University Press (2014)

³² Ahmed (3578). Në një transmetim tjetër, Usama bin Sherik përcjell se beduinët thanë: “O i Dërguar i Allahut, a të mjekohemi?” Ai tha: “Kërkoni mjekim, se Allahu nuk krijoi ndonjë sëmundje e të mos ketë krijuar edhe ilaçin për të, përveç njërës.” Ata thanë: “Cilës, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “Plakjes.” Ebu Daud (2/331), et-Tirmidhi (3/258), dhe Ibn Maxhe (2/1137).

Medical Library Association, tha: “Kanuni i Avicenës (Ibn Sina) ka mbetur një bibël mjekësie në Evropë për një periudhë më të gjatë se çdo punim tjetër.”³³

Në fakt, peygamberi Muhamed ﷺ prezantoi edhe karantinën moderne mjekësore. Kur Umeri ؓ, trashëgimtari i dytë i udhëheqjes së tij, mbërriti një vend të quajtur Sargh gjatë udhëtimit të tij, u informua se në vendin ku ishte nisur (Sham) kishte rënë mortaja. Abdu-Rrahmaan ibn Auf ؓ, një tjetër shoqëruar si peygamberit ﷺ i tregoi Umerit ؓ se peygamberi ﷺ kishte thënë:

“Kur të dëgjoni se në një vend ka rënë mortaja, mos hyni aty. Nëse bie mortaja aty ku gjendeni, mos ikni nga aty.”³⁴

Lidhur me rilindjen e dijes, të ndezur udhëzimi i Muhamedit ﷺ, Franz Rosenthal i Universitetit Yale, thotë në librin e tij *Knowledge Triumphant*:

“Sepse dija është një nga ato koncepte që dominuan Islamin dhe i dhanë civilizimit islamik formën e tij të dalluar dhe ngjyrimin. Në fakt, s’ka tjetër koncept që ka funksionuar si një faktor përcaktues i civilizimit islamik në të gjitha aspektet e veta sikurse dija ... S’ka asnjë degë të jetës intelektuale muslimane, të jetës politike e fetare muslimane, dhe të jetës së përditshme të një muslimani të rëndomtë që ka mbetur e paprekur nga qëndrimi gjithëpërfshirës ndaj dijes si diçka e një vlerë sipërore për qenien muslimane. Dija është Islam, edhe pse teologët kanë ngurrar ta pranojnë korrektësinë teknike të këtij barazimi. Vetë fakti i diskutimi të tyre të zellshëm të këtij koncepti dëshmon për rëndësinë e tij themelore për Islamin.”³⁵

Në një libër tjetër, *A History of Muslim Historiography*, Rosenthal thekson se Kurani jo vetëm që stimuloi hulumtimin historik, por ndryshoi kursin e historisë, kur kemi të bëjmë me historiografinë. Arsyeja, argumenton ai, është se veprimet e individëve (si peygamberët), ngjarjet e së kaluarës, dhe rrethanat e të gjithë njerëzve në tokë janë bërë çështje me rëndësi fetare, krahas të dhënave të shumta historike në Kuranin të cilin e solli Muhamedi ﷺ, që nxiti gjurmimin e informatave të tjera historike shpjeguese.

Robert Briffault (vdiq 1948), një kirurg britanik dhe autor i çështjeve të antropologjisë sociale, tha:

“Shkenca është kontributi më i rëndësishëm i civilizimit arab ndaj botës moderne ... Borxhi që shkenca jonë ia ka asaj arabe nuk përbëhet nga zbulime të mahnitshme apo teori revolucionare; shkenca i ka borxh arabëve

³³ “[The Significance of Ibn Sina's Canon of Medicine in the Arab and Western worlds.](#)” Science and Its Times: Understanding the Social Significance of Scientific Discovery. *Encyclopedia.com*. 11 Jan. 2017.

³⁴ El-Buhari (5729) dhe Muslim (98).

³⁵ Rosenthal, Franz. *Knowledge Triumphant*. Boston: Brill, 2007. p. 2

ekzistencën e vet ... Soditjet dhe eksperimenti janë dy burimet e dijes shkencore ... Metoda greke e arritjes së dijes shkencore ishte kryesisht spekulative, prandaj shkenca s'mundi të përparonte shumë ... As Roger Bacon e as adashi i tij i vonë nuk kanë ndonjë meritë për prezantimin e metodës eksperimentale ... Roger Bacon s'ishte asgjë më shumë sesa një dishepull i shkencës muslimane dhe i një metode për Evropën e krishtere; dhe ai asnjëherë nuk u lodh së deklaruar se dija e arabishtes dhe shkencës arabe për bashkëkohësit e tij qenë mënyra e vetme e arritjes deri te dija e vërtetë.”³⁶

Përfundim

Pejgamberi Muhamed ﷺ nuk qe vetëm një jetim i cili përvetësoi botën me përdëllimin e tij, por një bari analfabet, i cili ofroi një prizëm të jashtëzakonshëm, që i përgjigjet çdo pyetjeje teologjike, etike e civilizuese deri në përfundimi e kohës. Ai paraqiti një porosi me një substancë të pamasë, të çiftëzuar me ligje të akorduara siç është më së miri, të cilat mbeten aq fleksibile sa porosia të mbetej përherë e rëndësishme dhe të mos i humbte vlera. Një vitalitet i këtille reflekton baraspeshën e përsosur që qe skalitur - pa asnjë fazë testuese – në mësimet e tij. Ai poqë i ofroi botës një porosi përfundimtare, por një që po ashtu është mjaftueshëm e lakueshme për t'u përputhur me transformimet në dinamikën e botës, të cilat ishin të paimagjinueshme për mendjet më të ndritura 1400 vite më herët.

Me këtë po përmbylim turneun tonë të asaj që disa e përshkruajnë si mrekullia intelektuale e pejgamberit Muhamed ﷺ, pra atë se porosia e tij qe aspekti më tërheqës i pejgamberllëkut të tij dhe treguesi më i madh i origjinës së tij hyjnore.

³⁶ *The Making of Humanity*, by Robert Briffault